

MODEL – K.A

KËRKESË ANKIMORE

Drejtuar: Komisionit të Ankimeve dhe Sanksioneve (KAS) në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve

Adresa: Rruga “Ibrahim Rugova”, Ndërtesa nr. 4: Tiranë

ANKUESI	
Subjekti Ankues	Adresa, posta elektronike dhe/ose nr. i telefonit Bulevardi “Zhan d’Ark”, nr. 11, Tiranë. Email: pd@rithemelimi.com
PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË (PD)	

<u>OBJEKTI I ANKIMIT</u>	
1. Kundërshtimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 172, datë 14.03.2023; dhe	
2. Ndryshimin e vendimit duke vendosur, Regjistrimin e Partisë Demokratike të Shqipërisë të përfaqësuar nga Kryetari Sali Berisha, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.	

Vendimi	<u>TITULLI I VENDIMIT</u> “Për shqyrtimin e kërkesës së “Partisë Demokratike” për regjistrimin si Subjekt Zgjedhor për Zgjedhjet për Organet e Qeverisjes Vendore të Datës 14 Maj 2023”
---------	---

Nr.	Datë
172	14/03/2023

1. Kundërshtimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 172, datë 14.03.2023; dhe	
2. Ndryshimin e vendimit duke vendosur, Regjistrimin e Partisë Demokratike të Shqipërisë të përfaqësuar nga Kryetari Sali Berisha, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.	

BAZA LIGJORE:
Neni 4, pika 1 e Kushtetutës së Shqipërisë; Nenet: 3, 8, 10, 12, 13, 19, neni 21, 26, nenet 63, 64, Neni 124 e vijues, si dhe nenet 136, 139, 140, 141 e vijues të Ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.




Nënshkrimi i Ankuesit

PËRSHKRIMI I SHKELJES SË PRETENDUAR

Partia Demokratike e Shqipërisë e përfaqësuar nga Kryetari Sali Berisha, në datë 05.03.2023 ora 21:15, ka paraqitur pranë KQZ dokumentacionin e plotë administrativ dhe ligjor për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet vendore të datës 14 Maj 2023, kërkesë e regjistruar në KQZ me nr. Prot. 1329.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve pasi mori në shqyrtim kërkesat me nr. 1329 Prot., datë 5.3.2023 dhe kërkesë me nr. 1337 Prot., datë 06.03.2023, me Kërkuar: 1) Z. Indrit Sefa, në cilësinë e përfaqësuesit të z. Lulëzim Basha si kryetar i "Partisë Demokratike" dhe 2) Z. Sali Berisha, përfaqësuar nga Z. Ledio Nuraj dhe Z. Franci Nuri, me objekt: **Regjistrimi i "Partisë Demokratike"/ "Partisë Demokratike të Shqipërisë" si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023**, si dhe pasi i bashkoi dy kërkesat në një çështje të vetme, në seancën publike të datës 9 Mars 2023, me Vendimin Nr. 158, ka vendosur:

- "1. Kthimin për plotësim të dokumentacionit për regjistrim si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023, "Partisë Demokratike" sipas arsyetimit të këtij vendimi.***
- 2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.***
- 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij"***.

Në datë 11 Mars 2023, Partia Demokratike e Shqipërisë me kryetar Sali Berishën j'u drejtua KAS-it për të kundërshtuar atë vendim të padrejtë të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve me kërkesën ankimore nr. 29.

Pas shqyrtimit të çështjes në seancë paraprake në datë 13.03.2023, KAS-i vendosi: ***"mos kalimin për shqyrtim të kërkesës ankimore nr. 29, të depozituar nga Partia Demokratike, përfaqësuar nga z. Sali Berisha"***. Nga faqja zyrtare web e KQZ (Kqz.gov.al) shpjegohet se ***"KAS konstatoi se ankuesi nuk legjitimohet sepse nuk ka interes të ligjshëm në një çështje që i përket një kërkuar tjetër dhe KAS-i nuk ka kompetencë në shqyrtimin e ankesës, pasi KSHZ nuk është shprehur me vendim përfundimtar për kërkesën e ankuesit"***. Ndërkohë që në shpjegimet e arsyetimit të vendimit të tij në seancë, KAS shpjegoi se për sa kohë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk ishte shprehur ende me vendim përfundimtar, nëse do të pranonte apo jo regjistrimin e PD si subjekt zgjedhor, atëherë vendimi nr. 158 i KSHZ konsiderohej vendim i ndërmjetëm, ndaj të cilit sipas KAS nuk lejohet ankim.

Në datë 14.03.2023, në ora 16.00, KSHZ vijoi shqyrtimin e çështjes së regjistrimit të Partisë Demokratike si subjekt zgjedhor, duke vërejtur se: ***"Z. Sali Berisha ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesën e "Partisë Demokratike" me nr. 1329 prot., datë 5.3.2023, për t'u regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore që do të zhvillohen në datën 14 maj 2023. Në vlerësimin paraprak të këtyre dy kërkesave, bërë edhe në seancën e datës 9.3.2023 rezultoi se z. Sali Berisha nuk ka legjitimitetin për të kërkuar regjistrimin e Partisë Demokratike si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023. Është fakti ligjor se z. Lulzim Basha është kryetar i Partisë Demokratike"***.

Në përfundim të seancës publike, pasi dëgjoi përfaqësuesit e palëve, Komisionerit Celibashi, vendosi përfundimisht :



- "1. Të mos regjistrojë "Partinë Demokratike" me kryetar z. Lulzim Basha, me shkronjat nistore "PD" ose "PDSH" si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.***
- 2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.***

3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij”.

Duke e kundërshtuar me forcë këtë vendim arbitrar të Komisionerit, i cili pa asnjë bazë juridike nuk e legjitimoi subjektin Partia Demokratike e Shqipërisë me kryetar Sali Berisha, brenda afatit të përcaktuar për akimim, po paraqesim këtë ankimimi për të kundërshtuar vendimin nr. 172, datë 14.03.2023 të KSHZ Ilirjan Celibashi, si një vendim të padrejtë, antikushtetues dhe antiligjor, i cili përmban parregullsi të cilat do të përshkruhen në vijim të arsyetimit ligjor se ku mbështetet ankimi.

Partia Demokratike e Shqipërisë është krijuar sipas Urdhërit Nr.12 datë 19.12.1990 të Ministrit të Drejtësisë dhe rezulton e regjistruar në Regjistrin e Partive Politike.

Regjistrimet e akteve të fundit të këtij subjekti, në Regjistrin e Partive Politike, datojnë ato të pas Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike të 29 Prillit 2018. Këto regjistrime përfshijnë pasqyrimin në regjistër të organeve drejtuese të PDSH si Këshilli Kombëtar, Kryetari i Partisë, Sekretari i Përgjithshëm dhe sekretariatet.

Gjithashtu të regjistrueshme, por ende të papasqyruara në Regjistrin e Partive Politike, janë vendimet e Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike të Shqipërisë të datës 17 Korrik 2021, dhe organet drejtuese të dala nga ky Kuvend, me përjashtim të Kryetarit të Partisë.

Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, më datë 16.12.2021 është depozituar kërkesa e palës kërkuese “Partia Demokratike e Shqipërisë”, përfaqësuar nga Komisioni i Rithemelimit, në referim të Ligjit Nr.8580 datë 17.02.2000 “Për Partitë Politike”, i ndryshuar.

Objekt i kërkesës, ishte **depozitimi i ndryshimeve statutore, sipas vendimeve të marra nga Kuvendi i Partisë Demokratike i datës 11.12.2021**, Kuvend i cili ishte thirrur referuar parashkimeve statutore nga ¼ e anëtarëve/delegatëve të Kuvendit.

Me vendimin nr. 3 datë 25.03.2022, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur:


- Pranimin e kërkesën së palës kërkuese, Partia Demokratike e Shqipërisë përfaqësuar nga Komisioni i Rithemelimit:

- Depozitimimin e vendimeve të Kuvendit të PDSH duke regjistruar ndryshimet përkatëse në rregjistrin e partive politike:

- *Vendimin Nr.1 datë 11.12.2021, me anekset bashkëlidhur Statutin e Partisë Demokratike, të Kuvendit Kombëtar të Partisë;*
- *Vendimin Nr.2 datë 11.12.2021, të Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike;*
- *Vendimin Nr.3 datë 11.12.2021, të Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike;*
- *Vendimin Nr.4 datë 11.12.2021, të Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike;*
- *Vendimin Nr.5 datë 11.12.2021, të Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike;*
- *Vendimin Nr.6 datë 11.12.2021, të Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike;*
- *Vendimin Nr.7 datë 11.12.2021, të Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike.*



- Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim sipas ligjit.


Nenskrifti T. Ankuësi

Kundër këtij vendimi ka bërë ankim deputeti Enkelejd Alibeaj pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, cila me vendimin nr. 44, datë 03.03.2023, vendosi:

1) *Mospranimin e ankimit të ankuesit Partia Demokratike të Shqipërisë përfaqësuar nga Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit, të ushtruar ndaj vendimit nr. 508 rregj. them., datë vendimi 22.04.2022 me objekt "Disponim ankimi" të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, si vendim ndaj të cilit nuk lejohet ankim.*

2) *Prishjen e vendimit nr. 3, datë 25.03.2022 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe dergimin e çështjes për rigjykim pranë asaj gjykate me tjetër trup gjykues.*

3) *Kundër këtij vendimi lejohet rekurs i veçantë në Gjykatën e Lartë brenda 5 ditëve, duke filluar ky afat nga dita e nesërme e komunikimit të vendimit të arsyetuar.*

Në funksion të regjistrimit si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e përgjithshme vendore të datës 14.05.2023 për kryetarë të bashkive, Partia Demokratike ka detyrimin politik dhe ligjor të paraqesë kërkesën përkatëse për regjistrim si subjekt zgjedhor pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, sipas parashikimeve të nenit 64 të Kodit Zgjedhor, por në raport me komizën ligjore ekzistuese konstaton se gjendja aktuale e organeve të saj më të larta drejtuese, krijuar me vullnet të lirë nga anëtarësia e saj sipas disponimeve të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për Partitë Politike", i ndryshuar, nuk rezulton të jetë e pasqyruar në regjistrin e Partive Politike dhe si e tillë t'i vihej në dispozicion KQZ në përmbushje të detyrimeve që burojnë nga neni 64 i Kodit Zgjedhor.

Për sa më sipër, duke konsideruar se:

- **Kuvendi i Partisë Demokratike të Shqipërisë i datës 11.12.2021**, si dhe Statuti i PDSH dhe organet e partisë që burojnë prej tij janë aktet e fundit ligjore në fuqi, të regjistrueshme në Regjistrin e Partive Politike, sipas dispozitave të ligjit nr. 8580, datë 17.02.2000 "Për Partitë Politike", i ndryshuar.
- **Vendimi nr.3 datë 25.03.2022, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë**, i cili ka çertifikuar Kuvendin Kombëtar të Partisë Demokratike të datës 11.12.2021, është ende në fuqi i pashfuqizuar.
- **Vendimi nr.44, datë 03.03.2023 i Gjykatës së Apelit me Juridiksion të Përgjithshëm është një vendim jo përfundimtar dhe jo i formës së prerë** në kuptim të parashikimeve të nenit 451, shkronja "ç", i Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë, i cili do të rekursohet nga ana jonë sapo të na komunikohet vendimi i arsyetuar nga Gjykata e Apelit.
- **Rekordet e organeve drejtuese të Partisë Demokratike të Shqipërisë që figurojnë të pasqyruara në Regjistrin e Partive Politike janë të vjetra dhe nuk pasqyrojnë korrektësisht organet drejtuese të saj**, veçanërisht përsa i përket ish-kryetarit të partisë z. Lulzim Basha i cili, përveçse është shkarkuar nga kjo detyrë në Kuvendin Kombëtar të datës 11.12.2021 ka dhënë edhe dorëheqjen me një akt publik në datën 21.03.2022.
- **Kërkesa për regjistrim e subjektit zgjedhor në zgjedhje**, sipas nenit 64 të Kodit Zgjedhor dhe akte të tjera që lidhen me të, janë akte ekskluzive të cilat i takojnë Kryetarit të Partisë dhe nuk mund të delegohen te asnjë tjetër.
- **Mospasqyrimi i akteve të sipërcituara, në regjistrin e Partive Politike mund të rrezikojë proceduralisht, për herë të parë që nga viti 1990 regjistrimin e partisë më të madhe të opozitës në procesin zgjedhor.**



FAKTET, ARGUMENTAT, DISPOZITAT LIGJORE KU MBËSHTETET ANKIMIMI.

Nënshkrimi i Ankuesit

Të gjitha faktet, indiciet dhe provat në disponimin tonë, provojnë në mënyrë të qartë dhe të pakundërshtueshme se PD e përfaqësuar me kryetar z. Sali Berisha duhet të regjistrohet si subjekt zgjedhor nga KQZ:

1. Partia Demokratike e Shqipërisë i ka vënë në dispozicion KQZ, të gjithë dokumentacionin ligjor mbi bazën e të cilit provohet lehtësisht se kryetar i Partisë Demokratike është Sali Berisha.
2. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në Nenin 4, pika 1, parashikon se: **“E drejta përbën bazën dhe kufijtë e veprimtarisë së shtetit”**. Në rastin konkret, KQZ nuk mund të refuzojë regjistrimin e PD përfaqësuar nga Sali Berisha vetëm bazuar mbi mungesën e shkresës së regjistrimit të partive politike, ku fatkeqësisht në regjistër vijon të mbeten të dhëna të pasakta dhe të vjetëruara, që datojnë qysh nga regjistrimet e vitit 2018.
3. KQZ duhet t’u lexojë dhe interpretojë Kodin Zgjedhor në tërësinë e tij, pa i analizuar të veçuar dispozitat e ndryshme të Kodit. Konkretisht, për përcaktimin e kryetarit të një Partie Politike KQZ nuk mundet që informacion t’u bazojë vetëm dhe ekskluzivisht nga regjistri i partive politike (Neni 64 i Kodit Zgjedhor), duke injoruar faktet e njohura botërisht të cilat kanë forcën e provës sipas vetë Nenit 139, pika 1 e Kodit Zgjedhor. Referuar kësaj dispozite të Kodit Zgjedhor, përcaktohet shumë qartë se: **“Për faktet, të cilat janë të njohura botërisht, si dhe për ato fakte, të cilat janë të ditura për KQZ-në, për shkak të funksioneve të saj, nuk nevojitet verifikimi”**. E zbatuar në rastin konkret rreth problematikës së pasqyrimin të emrit të Kryetarit të PD në regjistrin e partive politike, për të zgjidhur drejt çështjen e regjistrimit të PD si subjekt zgjedhor, KQZ kishte detyrimin që të merrte në konsideratë edhe faktet e njohura botërisht, siç janë konkretisht:

(i) Shkarkimi i Lulzim Bashës nga anëtarësia e PD në Kuvendin e 11 Dhjetorit 2021 dhe e konfirmuar me Referendumin e datës 18 Dhjetor 2021 ;

(ii) Dorëheqjen publike të Lulzim Bashës në datë 21.03.2022 ; si dhe

(iii) Zgjedhjen e Sali Berishës si Kryetar i PD pas referendumit të anëtarësisë në Maj 2022.

4. Nisur nga sa më sipër, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nuk mund të merrte në shyrtime fare kërkesën për regjistrim të paraqitur nga përfaqësuesit e ish-Kryetarit të PD Lulzim Basha, për sa kohë janë fakte të njohur botërisht se Basha është shkarkuar nga anëtarësia e PD si dhe gjithashtu është fakt i njohur botërisht që në datë 21 Mars 2022 ky i fundit ka dhënë dorëheqjen publike nga funksioni që vijonte të mbante padrejtësisht. Në dosjen e regjistruar në KQZ në datë 05.03.2023, PD ka paraqitur edhe vendimet e marra nga Kuvendi Kombëtar i 11 Dhjetorit 2021, ku një nga vendimet është edhe shkarkimi i kryetarit Lulzim Basha. Po ashtu, është fakt i njohur botërisht se Lulzim Basha ka dhënë dorëheqjen me vullnet të lirë në 21 Mars 2021, pas disfatës së tij elektorale në zgjedhjet e pjesshme vendore. Kjo gjë u pranua publikisht jo vetëm nga përfaqësuesit e L. Bashës në seancën e datës 14.03.2023, por edhe nga vetë Komisioneri i cili ishte i vetëdijshëm se L. Basha kishte dhënë dorëheqjen nga drejtimi i PD (fakt i njohur botërisht). **Në këto kushte, si mundet të legjitimohej kërkesa e përfaqësuesve me “Autorizim” nga Lulzim Basha, në kushtet ku, si nga këta të fundit,**




NenshKrimi Lankuesit

si nga Komisioneri Celibashi u pranua se Basha kishte dhënë dorëheqjen [Fakt ky i njohur botërisht] ? Sa vlerë juridike paska një “autorizim” i dikujt që ka dhënë dorëheqjen para 1-viti ?

5. Për sa kohë lajmi i dorëheqjes së Lulzim Bashës ka qënë publik, i transmetuar gjerësisht nga mediat vendase dhe të huaja, gjykojmë se edhe KQZ kishte marrë dijeni lidhur me këtë fakt të njohur botërisht edhe për shkak të funksioneve të saj në organizimin e proceseve zgjedhore të subjekteve apo partive politike.
6. Sidoqoftë, me këtë ankimim, ne kërkuesit po paraqesim edhe prova të publikimit të lajmit / faktit të njohur botërisht, se më datë 21.03.2022 Lulzim Basha është dorëhequr publikisht nga drejtimi i Partisë Demokratike. Prej asaj date ish-Kryetari Basha jo vetëm që është tërhequr nga jeta politike aktive, por pothuajse ka braktisur edhe institucionin e Kuvendit të Shqipërisë ku vijon ende sot e kësaj dite të mbajë detyrën e deputetit.
7. Nga ana tjetër, është po fakt i njohur botërisht se zgjedhja e Lulzim Bashës në vitin 2021 është kontestuar në Gjykatë që në Qershor 2021 nga rivalja e tij në garë Edith Harxhi. Pra paraqitja e L.Bashës në fletën e regjistrimit të partive nuk është as aktuale dhe as përfundimtare. Së dyti, Lulzim Basha u shkarkua nga Kuvendi i PD i 11 dhjetorit 2021. Gjykata e Apelit nuk rrëzoi Kuvendin e 11 Dhjetorit 2021, por vendimin e gjykatës që urdhëroi regjistrimin e tij në regjistrin e Partive dhe apeli urdhëroi rishqyrtimin e tij, përfshirë shkarkimin e Lulzim Bashës.
8. Nëse trajtojmë vetëm dorëheqjen, vlen të theksohet se Kushtetuta dhe ligji e njohin dorëheqjen si mekanizëm kryesor për përfundimin e parakohshëm të një mandati kushtetues (*presidenti, deputeti, kryeministri, etj*) apo ligjor. Kur jepet dorëheqja nuk ka diskutim sepse është akt individual vullneti. Pasoja është përfundimi i menjëhershëm i mandatit. Për t’u rikthyer në mandat duhet që personi të rizgjidhet apo riemërohet. Statuti i PD ka të njëjtat parashikime. Kur një kryetar dorëhiqet, duhet zgjedhur një i ri. Në periudhën e ndërmjetme, Këshilli Kombëtar duhet të zgjedhë një nga nënkryetarët që të ushtrojë përkohësisht detyrën e kryetarit, deri sa të zgjidhet i riu (jo deri sa të zgjohet i vjetri). Pra, pa llogaritur që demokratët e shkarkuan edhe me referendum më 18 dhjetor 2021, Lulzim Bashës i ka mbaruar mandati edhe me statutin e tij të korrikut 2021. Meqenëse Këshilli Kombëtar nuk është mbledhur të zgjedhë një nënkryetar të përkohshëm, nuk ka një kryetar në detyrë as sipas atij statuti të Bashës që më pas u shfuqizua më 11 dhjetor 2021.
9. Të njohësh ende Lulzim Bashën si kryetar të PD sot, 1-vit pas shkarkimit dhe dorëheqjes së tij, pavarësisht se PD ka zgjedhur kryetarin e saj Sali Berisha në Maj 2022 me referendum të anëtarëve, nuk është gjë tjetër veçse konfuzion, keqdrejtim dhe mashtrim i qëllimshëm i zgjedhësve, pra shkelje e barazisë në zgjedhje. Po ashtu, të pretendosh të legjitimosh për regjistrim në KQZ një subjekt zgjedhor me një kryetar të dorëhequr para 1-viti, vetëm se emri i tij ka ngelur aksidentalisht apo gabimisht në fletën e regjistrimit të partive politike sot që flasim, përveç shkeljeve ligjore (*veprim ky juridik absolutisht i pavlefshëm për shkak se po tentohet në mashtrim të Ligjit*) nuk është gjë tjetër



[Signature]

veçse ientativë për të penguar opozitën të garojë në kushtë të barabarta me PS dhe partitë e tjera politike.

- 10. Nga ana tjetër, të gjitha të dhënat e prezantuara nga Partia Demokratike e përfaqësuar nga Kryetari Sali Berisha janë të sakta, reale, të përditësuara dhe në përputhje me kuadrin ligjor.** Aktualisht, mos-fshirja e emrit të Lulzim Bashës dhe mos-pasqyrimi i emrit të z. Berisha në regjistrin e partive politike vjen si rezultat i zvarritjeve të qëllimshme të vendimeve gjyqësore, me qëllimin e vetëm dëmtimin e opozitës reale në vend dhe shkeljen e barazizë në zgjedhje për të favorizuar deri në fund mazhorancën qeverisëse.
- 11. Edhe vendimi i fundit i Gjykatës së Apelit, i shpallur jo pa qëllim të premtën datë 03.03.2023 (pra vetëm 3-ditë përpara skadencës së afatit maksimal të lejuar nga Kodi Zgjedhor për regjistrimin në zgjedhjet vendore të subjekteve politike), tregon për paramendim lidhur me zvarritjen me gati 1-vit i atij procesi dhe lënia e gjykimit në limitet kohore.** Pavarësisht se vendimi i marrë nga Apeli rezultoi një vendimmarrje e ndërmjetëme, ndaj të cilës lejohet rekurs i veçantë në Gjykatë të Lartë, (pra nuk vendimi i Apelit nuk rezultoi një vendim i formës së prerë), sërish efekti i tij ishte që direkt apo indirekt të pengojë apo vonojë regjistrimi si subjekt zgjedhor i Partisë Demokratike me kryetar Sali Berishën. Ky është fakt i padiskutueshëm.
- 12. Ndryshe nga dosja e plotë dhe e saktë e paraqitur nga Partia Demokratike me kryetar Sali Berishën, dosja tjetër a ardhur në KQZ me firmë dhe vulë të ish-Kryetarit Basha, tregonte jo vetëm mungesë të theksuar dokumentacioni, por dëshmon gjithashtu edhe për mungesë serioziteti:**
- 13. Së pari,** të gjithë e kuptuan se “Autorizimi” i pretenduar se ishte nënshkruar nga Basha para 1 viti (mban datën 18 Mars 2022), në fakt shfaqte dyshime tek çdokush se mund të ishte fabrikuar para pak ditësh. Një shkresë pa numër protokollit, nuk garanton aspak se data e saj të jetë data reale, për sa kohë numri i protokollit lejon gjurmimin e shkresës së pretenduar. Shkresa në fjalë pretendohet se është nxjerrë nga zyrat e PD në 18 Mars 2022, vetëm 3-ditë para dorëheqjes publike të Bashës. Në një kontekst të vështirë politik të ngjarjeve të ditës, fill pas disfatës elektorale të 6 Marsit 2022, të gjithë e kanë fare të qartë se askujt nuk në PD i shkonte ndër mend të merrej me zgjedhjet vendore të vitit 2023, (data e të cilave u mësua vetëm në Tetor 2022), aq më pak për këtë të preokupohej L.ulzim Basha i cili zgjedhjet e fundit vendore në 2019 PD nuk mori pjesë sepse Basha i bojkotoi me vetëdije të plotë. Por edhe gjuha e formulimit të asaj shkrese duhet të ngjallte dyshime serioze tek Komisioneri dhe tek KQZ, veçanërisht ku në shkresë flitet për **“datë të caktuar nga Presidenti i Republikës”** në një kohë që koha e brendshme e shkresës ishte e para 1-viti dhe me llogjikë duhej të përdorej koha e ardhme **“datën që do të caktojë Presidenti...”**. Ky element i fundit, i parë edhe nga mungesa e nr. të protokollit të shkresës, ngre dyshime serioze se kjo shkresë nuk është hartuar në kohën dhe datën e pretenduar (18 mars 2022), por mund të jetë fabrikuar kohët e fundit, sidoqoftë pasi data e zgjedhjeve të 14-majit ishte shpallur nga Presidenti i Republikës.



Sali Berisha
Nënshkrimi i Ankuesit

14. **Së dyti**, sikundër e evidentoi edhe Komisioneri Celibashi në seancën publike të datës 09.03.2023, ky “*autorizim*” i paraqitur nga përfaqësuesi i L. Bashës, nuk mbart elementët e duhur nga forma dhe substanca, pikërisht sepse nuk akti është i qartë dhe shterues lidhur me delegimet, si dhe lë vënd për më shumë se një interpretim lidhur me regjistrimin e partisë për vendore të 14-Majit 2023, për sa kohë autorizimi parashikon “*Regjistrimin në zgjedhjet e përgjithëshme vendore të vitit 2023*” dhe nuk ka përcaktuar saktë emrin e zgjedhjeve (duhet të ishte : “*zgjedhjet e organeve të pushtetit vendor të 14-Majit 2023*”).
15. **Së treti**, edhe sikur autorizimi të ishte plotësisht i rregullt në formë dhe përmbajtje, fakti i njohur botërisht se Lulzim Basha nuk është më kryetar i PD pasi ka dhënë dorëheqjen në datë 21.03.2022 do të bënte që të pushonin tagrat e përfaqësimit fill me dorëheqjen e tij. **Pra autorizimi i tij sot ka ZERO fuqi juridike.** Autorizimi apo delegimi i kompetencave marrin fund në çastin kur personi që delegon nuk ka më personalitet juridik apo nuk gëzon më të drejtat apo detyrimet që pretendon se po delegon për të ardhmen. Pas uajit maj 2022, Partia Demokratike ka një Kryetar të ri të zgjedhur dhe ai është Sali Berisha. Z. Berisha ka dhënë autorizim që PD-në në KQZ t’a përfaqësojnë të poshtëshënuarit dhe jo personat e tjerë të paraqitur në këtë seancë përpara KAS.
16. **Së katërti**, mos-nënshkrimi i deklaratës së përgjegjësisë personale nga Basha, pra nga ai që pretendon se qenka sërish “kryetar” i partisë, por nënshkrimi i kësaj deklarate nga një person i tretë i autorizuar nga ky i fundit, padyshim që përbën shkelje ligjore për sa kohë, në mashtrimi të ligjit, është tentuar të regjistrohet subjekti duke shmangur dhe bërë jo-efektive angazhimin solem, i detyrueshëm për KQZ.
17. **Përfundimisht, duke mos-marrë për bazë faktet e njohura botërisht, sikundër kjo përcaktohet shprehimisht edhe nga vetë Kodi Zgjedhor – Neni 139, pika 1 – Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në gjykimin tonë ka shkelur Kodin Zgjedhor, procedurat dhe ligjin duke vendosur mospranimin e regjistrimit të PD përfaqësuar nga z. Sali Berisha si subjekt zgjedhor.**

Nisur nga sa më sipër, KAS duhet të ndryshojë vendimin objekt ankimi të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, duke detyruar KQZ që të bëjë regjistrimin e Partisë Demokratike me Kryetar Sali Berisha, si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e përgjithëshme vendore të datës 14.05.2023, në përputhje me parashikimet e nenit 64, 139 e vijues të Kodit Zgjedhor dhe sipas jurisprudencës së krijuar nga vetë KQZ me vendimin e saj nr. 230 dt.27.04.2019, sipas dokumentacionit që do të gjeni bashkëlidhur.

Përfundimisht, bazuar mbi sa u argumentua më lart, Partia Demokratike e Shqipërisë e përfaqësuar nga Kryetari i saj z. Sali Berisha,

Kërkon:

1. Kundërshtimin e vendimit të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 172, datë 14.03.2023; dhe
2. Ndryshimin e vendimit duke vendosur, Regjistrimin e Partisë Demokratike të Shqipërisë të përfaqësuar nga Kryetari Sali Berisha, si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.



PROVAT QË PARAQITEN DHE / OSE KËRKOHEN, BURIMIN SI DHE NUMRI I TYRE.

1. Vendimi i datës 09.03.2023 i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve;

Sali Berisha
Nënshkrimi / Ankuesit

2. Shkrim nga shtypi i huaj, **Deutsche Welle**: “*Lulzim Basha jep dorëheqjen si kryetar i Partisë Demokratike*” – publikuar më datë 21.03.2022. **Link**: <https://www.dw.com/sq/lulzim-basha-jep-dor%C3%ABheqjen-si-kryetar-i-partis%C3%AB-demokratike/a-61206806>
3. Shkrim nga shtypi i huaj, **Radio Evropa e Lirë**: “*Lulzim Basha jep dorëheqje nga kreu i PD-së*” – nga Gresa Kraja, datë 21.03.2022. **Link**: <https://www.evropaelire.org/a/lulzim-basha-doreheqje-pd-/31763595.html>
4. Shkrim nga shtypi i huaj: **Zëri i Amerikës (VOA)**: “*Shqipëri, Basha jep dorëheqjen nga drejtimi i PD-së*” – 21.03.2022. **Link**: <https://www.zeriamerikes.com/a/6494649.html>
5. Shkrim i Agjencisë Telegrafike Shqiptare (ATA): “*Basha jep dorëheqjen si kryetar i PD*” - nga Ilir Vata, datë 21/03/2022. **Link**: <https://ata.gov.al/2022/03/21/basha-jep-doreheqjen-si-kryetar-i-pd/>
6. Shkrimi i Gazeta Tema: “*Edith Harxhi dorëzon padinë në Gjykatën e Tiranës për Lulzim Bashën: Kërkova çregjistrimin e tij si kryetar*” – 22.11.2022. **Link**: <https://www.gazetatema.net/politika/harxhi-dorezon-padine-ne-gjykatene-tiranes-lulzim-basha-te-cregjistroh-i365729>
7. Të gjithë dokumentat që gjenden në dosjen e dorëzuar në KQZ datë 05.03.2023, përkatësisht:
 - (i) Shkresa nr. 80 prot., datë 05.03.2023 “Përcillet dokumentacion për regjistrim subjekti zgjedhor”;
 - (ii) Shkresa nr. 79 prot., datë 05.03.2023 “Kërkesa për rregjistrim në KQZ të Partisë Demokratike”;
 - (iii) Vendimi nr. 3, datë 25.03.2022 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor – Tiranë;
 - (iv) Statuti i Partisë Demokratike të Shqipërisë, datë 11.12.2021;
 - (v) Vendimet I deri në 7, të Kuvendit Kombëtar të Partisë Demokratike;
 - (vi) Statuti i Partisë Demokratike të Shqipërisë, Korrik 2021;
 - (vii) Njoftimi për mediat dhe publikun, të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm;
 - (viii) Vendimi nr. 1, datë 16.12.2021, i Komisionit të Përkohshëm të Rithemelimit të PDSH;
 - (xix) Vendimi nr. 21, datë 27.05.2022 i Komisionit të Organizimit dhe Kontrollit të Operacioneve Elektorale, për zgjedhjen e Kryetarit të PD z. Sali Berisha.

Për Subjektin “Partia Demokratike e Shqipërisë” – “PD”

Kryetari

Sali Berisha

Tiranë, 15/03/2023



Sali Berisha
Nënshkrimi i Ankuesit